



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 2617/ Prot.
8

Pogradec, më 28.06.2024

VENDIM

NR. 73, DATË 27.06.2024

PËR MIRATIM TË IMPLEMENTIMIT NË RAST APROVIMI TË PROJEKTIT ME TITULL "HARMONIA E TRASHËGIMISË KULTURORE : LIDHJA KULTURORE QË BASHKON OHRIN DHE POGRADECIN-H2COPE"

Në kuadër të Programit Ndërkufitar Maqedoni e Veriut–Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantaresimit (IPA III) alokimi për vitin 2022.

Në mbështetje të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", VKM nr.450 datë 26.07.2018 "Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integrimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 1.2 Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia,

- Mbështetja dhe drejtimi i strukturave administrative të Bashkisë për përgatitjen e projekteve në kuadër të programeve të asistencës së Bashkimit Evropian si dhe informimi i qartë për Thirrjet për Aplikime të shpallura në kuadër të Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Territorial të Bashkimit Evropian.
- Bashkërendimi dhe koordinimi me strukturat e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak për përfshirjen e të gjitha projekteve të financuara nga donator në buxhetin vjetor si dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm si dhe parashikimin e detyrueshëm të kostos lokale, bashkëfinancimit, nëse ka dhe TVSH, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak



VENDOSI :

- 1.Të miratojë implementimin në rast aprovimi të projektit me titull "HARMONIA E TRASHËGIMISË KULTURORE : LIDHJA KULTURORE QË BASHKON OHRIN DHE POGRADECIN-H2COP " në kuadër të Programit Ndërkufitar Maqedoni e Veriut –Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantaresimit (IPA III) alokimi për vitin 2022.
- 2.Bashkia Pogradec si partner në këtë projekt bazuar në kushtet dhe kriteret e aplikimit në projektet IPA,në rastin e miratimit të këtij projektit nga vlerësuesit e Delegacionit Evropian,të marrë përsipër mbulimin e kostos së bashkëfinancimit të projektit dhe TVSH-në për projektin.
- 3.Të autorizohet administrata e Bashkisë Pogradec për zbatimin e vendimit si dhe të ndjek të gjitha hapat e duhura për ecurinë e projektit.
- 4.Për zbatim të këtij vendimi, ngarkohen Kryetari i Bashkisë.
- 5.Vendimi hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

NËN/KRYETARE E KESHILLIT

Miranda OLLDASHI



1.Miratuar me 18 vota

2.Vota Pro 18

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 28.06.2024